

## Shqipëria

### Raporti për Lirinë Ndërkombëtare të Fesë, për Vitin 2012

#### Përmbledhje Ekzekutive

Kushtetuta dhe ligje e politika të tjera e mbrojnë lirinë e fesë dhe, në praktikë, qeveria përgjithësisht e respektoi lirinë e fesë. Qeveria vazhdoi të trajtonte pretendime nga grupet fetare për kthimin ose kompensimin e pronave të shtetëzuara gjatë epokës së mëparshme komuniste; megjithatë, shumë prej pretendimeve për pronat mbetën të pazgjidhura. Gjatë vitit, prirja në respektimin nga qeveria të lirisë së fesë nuk ndryshoi në mënyrë domethënëse.

Nuk pati raportime për abuzim apo diskriminim nga shoqëria mbi bazën e përkatësisë fetare, besimit, apo praktikës fetare.

Zyrtarë të ambasadës së SHBA u takuan rregullisht me udhëheqës të qeverisë dhe ata fetarë për të diskutuar çështje të lirisë së fesë ngritur nga qytetarë, media dhe grupet fetare, përfshi rëndësinë e rikthimit të pronave fetare të konfiskuara gjatë kohës së komunizmit. Ambasada organizoi aktivitete për të promovuar lirinë e fesë, si për shembull iftare, tryeza të rrumbullakëta mbi lirinë e fesë, si dhe dialogun mes besimeve.

#### Seksioni I. Demografia Fetare

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, popullsia përbëhet nga 2.8 milionë banorë. Është e vështirë të vlerësohen përmasat e grupeve fetare sepse afro 20 përqind e të intervistuarve refuzuan të përgjigjeshin pyetjeve opsionale të regjistrimit mbi përkatësinë fetare. Një numër udhëheqësish fetarë i sfiduan rezultatet e regjistrimit. Sipas regjistrimit, myslimanët sunitë përbëjnë afro 57 përqind të popullsisë, katolikët romanë 10 përqind, të krishterët ortodoksë (Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë) afro 7 përqind, dhe bektashinjtë (një formë e sufizmit shiit) 2 përqind. Grupe të tjera përfshijnë Bahait, Dëshmitarët e Jehovahit, Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditës së Shtatë (mormonët). Komiteti Shtetëror për Kultet raporton mbi 230 grupe, organizata, fondacione, dhe institucione fetare që kryejnë aktivitetin e tyre në vend.

#### Seksioni II. Statusi i Respektimit të Lirisë Fetare nga Qeveria

##### Kuadri Ligjo/i Politikave

Kushtetuta dhe të tjera ligje e politika e mbrojnë lirinë e fesë.

Me ligj, vendi është shekullar. Sipas kushtetutës, nuk ka ndonjë fe zyrtare dhe të gjitha fetë janë të barabarta; megjithatë, komunitetet e myslimanëve sunitë, bektashinjve, ortodoksëve dhe katolikëve gëzojnë një shkallë më të lartë njohjeje dhe statusi social mbi bazën e pranisë së tyre historike në vend.

Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr dhe përpunon ankesa për diskriminim, përfshi ato që lidhen me praktikën fetare. Komiteti Shtetëror i Kulteve, nën juridiksionin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, rregullon marrëdhëniet midis qeverisë dhe grupeve fetare, mbron lirinë e fesë, dhe promovon bashkëpunimin dhe mirëkuptimin midis besimeve. Komiteti mban një regjistër dhe statistika për grupet e huaja fetare që kërkojnë ndihmën e tij. Ndhmon edhe punonjësit e huaj të grupeve fetare për t'u pajisur me leje qëndrimi.

Qeveria nuk kërkon regjistrim apo licensim të grupeve fetare. Çdo grup mund të përftojë status zyrtar duke u regjistruar me Gjykatën e Rrethit Tiranë si shoqatë jofitimprurëse, pavarësisht nëse grupi ka karakter kulturor, argëtues, fetar, apo humanitar. Regjistrimi iu jep grupeve fetare të drejtën për të

mbajtur llogari bankare, për të zotëruar prona, si dhe për të përfituar një nivel të caktuar përjashtimi nga taksat.

Kushtetuta kërkon marrëveshje të veçanta dypalëshe për të rregulluar marrëdhëniet midis qeverisë dhe grupeve fetare. Qeveria ka të tilla marrëdhënie me Kishën Katolike Romane (prej vitit 2002); me komunitetet myslimane, ortodokse dhe bektashiane (prej vitit 2008); dhe me Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë, një organizatë protestante ombrellë (prej vitit 2010). Mes avantazheve të tjera, marrëveshjet ofrojnë njohje zyrtare, kthim me përparësi të pronave, si dhe përjashtime nga taksat.

Sipas Ministrisë së Arsimit, shkollat publike janë shekullare dhe ligji ndalon indoktrinimin ideologjik e fetar. Feja nuk jepet si mësim në shkollat publike. Sipas shifrave zyrtare, grupet, organizatat, dhe fondacionet fetare kanë 135 shoqata e fondacione të lidhura me to që administrojnë 102 institucione arsimore. Me ligj, Ministria e Arsimit duhet të licensojë këto shkolla dhe programi mësimor duhet të përputhet me standardet kombëtare të arsimit. Grupet katolike dhe myslimane administrojnë shumë shkolla të licensuara nga shteti. Kisha Ortodokse administron shkolla fetare dhe një universitet.

Qeveria respekton festat e mëposhtme fetare si festa kombëtare: Nevruz (festuar nga komuniteti bektashi), Pashkët (katolikët dhe ortodoksët), Bajramin e Madh (Eid al-Fitr), Bajramin e Vogël (Eid al-Adha), dhe Kritshtlindjet.

#### Praktika e Qeverisë

Nuk pati raportime për abuzime të lirisë së fesë.

Qeveria vazhdoi të trajtonte pretendimet nga grupet fetare lidhur me kthimin ose kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë kohës së komunizmit; megjithatë, shumë pretendime pronësore mbetën të pazgjidhura. Pas arritjes së marrëveshjeve dypalëshe në vitin 2008 midis qeverisë dhe komuniteteve myslimane, ortodokse, dhe bektashiane, qeveria udhëzoi Agjencinë Shtetërore për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave që të jepte përparësi pronave të zotëruara nga grupet fetare. Megjithatë, sfidat administrative dhe ligjore të lidhura me pretendimet pronësore në përgjithësi e bënin kthimin e pronave të vështirë për individët dhe organizatat, përfshi grupet fetare, dhe përparimi ishte i ngadaltë. Për shembull, procedurat e ngecura administrative vazhduan ta pengonin komunitetin bektashian nga rimarrja e pronave në Ksamil, prona të cilat një gjykatë ia kishte kthyer në vitin 2009.

Mosmarrëveshjet për pronësinë dhe problemet me ndjekjen ose regjistrimin e titujve të pronësisë e bënin të vështirë që grupet fetare të merrnin toka të reja ku të ndërtonin vende praktike fetare. Disa grupe merrnin me qera ndërtesa ekzistuese, por raportuan që vështirësitë për blerjen e tokës dhe ngritjen e ndërtesave të veta e penguan aftësinë e tyre për të zhvilluar shërbesa fetare.

Komuniteti Islamik Shqiptar (KISH) vazhdoi të kërkonte leje ndërtimi për një xhami të re mbi një copë tokë në Tiranë që po i kthehej komunitetit nëpërmjet procesit kompleks të kompensimit të pronave pas komunizmit. KISH vazhdoi të punonte me qeverinë për të përfunduar kalimin e pronësisë.

Megjithëse nuk ka ndonjë pengesë ligjore kundër mbajtjes së veshjeve apo simboleve fetare, drejtorët e shkollave kishin të drejtën të përcaktonin standardet për ëshshjen e duhur, o e cila, me raste, përfshinte kufizimet për shfaqjen publike të simboleve fetare.

Një numër udhëheqësish fetarë sfiduan rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, duke pretenduar që zyrtarët e regjistrimit nuk kishin vizituar kurrë një numër të madh të besimtarëve të tyre. Gjithashtu, çoroditja lidhur me pasojat e vetë-identifikimit etnik dhe fetar mund të ketë bërë që shumë të intervistuar të mos e identifikonin përkatësinë e tyre fetare. Për shembull, grupet e pakicës etnike greke nxitën anëtarët e tyre ta bojkotonin regjistrimin, çka ndikonte në matjen e pakicës etnike greke dhe të Kishës Ortodokse Greke.

### Seksioni III. Statusi i Respektimit të Lirisë së Fesë nga Shoqëria

Nuk pati raportime për abuzim apo diskriminim nga shoqëria mbi bazën e përkatësisë, besimit, apo praktikës fetare.

Në përgjigje të publikimit online të një filmi anti-mysliman që ndezi protesta në shumë vende në shtator, udhëheqësit myslimanë në Shkodër organizuan aktivitete edukuese dhe një thirrje për dhurim gjaku në përpjekje për t'ia shërbyer komunitetit dhe për të edukuar publikun lidhur me fenë islame. Një numër udhëheqësish myslimanë dolën në televizion dhe bënë deklaratë publike që dënonin dhunën dhe nxisnin anëtarët e tyre që t'ia përgjigjeshin paqësisht videos fyese.

### Seksioni IV. Politika e Qeverisë së SHBA

Zyrtarë të ambasadës së SHBA vazhduan të nxisnin qeverinë që të trajtonte pretendimet për pronat fetare dhe t'ia kthente grupeve fetare ndërtesat, tokat dhe të tjera prona konfiskuar gjatë kohës së komunizmit. Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës angazhuan udhëheqësit fetarë dhe anëtarët e komuniteteve në aktivitete të tilla si iftarë dhe tryeza që promovonin tolerancën fetare. Ambasada po ashtu organizoi shumë aktivitete anëmbanë vendit për të promovuar lirinë dhe tolerancën fetare, përfshi vizita në medrese, shkolla publike të mesme, si dhe institucione të tjera arsimore. Ambasada sponsorizoi një program ku studentët në disa institucione arsimore fetare planifikuan dhe zbatuan projekte komunitare, përfshi disa që përqendroheshin tek nxitja e tolerancës. Zyrtarë të SHBA vizituan kisha, xhami e objekte fetare gjatë gjithë vitit për të shënuar praktika dhe festa fetare.

Në mars, ambasadori organizoi një dialog mes feve me të dërguarën e posaçme të SHBA për monitorimin dhe luftën kundër anti-semitizmit, përfaqësuesen e posaçme të SHBA për komunitetet myslimane, si dhe udhëheqësit myslimanë, bektashinj, katolikë, ortodoksë dhe të krishterë ungjillorë. Gjatë takimit, udhëheqësit fetarë shprehën mbështetje për njëri tjetrin dhe komunitetet e tyre si dhe pohuan që faktorët historikë çonin në harmoninë jetëgjatë ndërfeetare.